

RRIOLLZA AGOLLI

**KOMUNIKIMI GJUHËSOR NË KËNDVËSHTRIMIN STILISTIK:
STILISTIKA GJUHËSORE NË POEZINË VDEKJA E NOSITIT E
LASGUSH PORADECIT**

Abstrakt

Poezia është një ligjërim i veçantë. Ajo ka një organizim tërësor në të cilin mjetet e gjuhës përbëjnë një bashkësi të ndërlikuar prej nga përftohet një rrafsh kuptimor i ri¹. Përvoja njerëzore ka thënë se poezia është një prirje mes të pashprehshmes dhe asaj që komunikohet. Poezia në analizë të fundit është një punë me gjuhën. Në gjykimin e sotëm ajo që i jep vend qendror analizës letrare është bindja se format dhe kuptimet e letërsisë janë gjuhësore. Vlerësimi i mjeteve gjuhësore në një tekst letrar është thelbi i një analize stilistike. Tani është koha për të mos e konsideruar gjuhën letrare si diçka të krijuar *ex nihilo*²; ajo është para së gjithash një zhvillim i mëtejshëm i gjuhës së të gjithëve; vetëm motivet biologjike e shoqërore të kësaj gjuhe bëhen motive estetike. Sistemi i gjuhës është më i gjerë se mishërimi i tij konkret në një etapë të caktuar.

Në tekstet shkollore përgjithësisht nuk i kushtohet rëndësi stilistikës gjuhësore. Për të njohur strukturën e tekstit letrar, e cila është edhe vetë kuptimi i tij, duhet para së gjithash ta njohim strukturën gjuhësore. Rivlerësimi i një veprë letrare, interpretimi i saj sipas disa mjeteve specifike, që të sugjeron vetë vepra në radhë të parë, ndriçon anë të panjohura të saj, deshifron mesazhet që fshihen në tekstin poetik. Një analizë stilistike gjuhësore kërkon t'i qëndrosh sa më afër tekstit, të shqyrtosh elementet gjuhësorë të tij (pa rënë natyrisht në një analizë thjesht artistike apo thjesht linguistike). Mësuesi merr shkas nga ato që di ai vetë për një shkrimtar dhe përpiket t'i gjejë në tekstin për studim. Analiza e vërtetë stilistike nis nga vetë teksti për të shkuar tek autori. Kjo mënyrë i krijon mundësinë nxënësit të gjykojë e të mendojë në mënyrë të pavarur.

Fjalë çelës: Poezia, stilistika gjuhësore, shprehësia, vështrim leksikologjik, rrafsh fonetik.

Metodat: Studim teksti, vëzhgim dhe hulumtim, interpretim gjuhësor.

Poezia është një ligjërim i veçantë. Ajo ka një organizim tërësor në të cilin mjetet e gjuhës përbëjnë një bashkësi të ndërlikuar prej nga përftohet një

¹ Shih R. Petro, L. Mëniku, *Për gjuhën e letërsisë* në "Çelësi i letërsisë dhe gjuhës shqipe", Albas, Tiranë, 2012, f. 27.

² Shih Sh. Bali, përkthyer nga M. Samara, *Dy konceptime për stilistikën* në "Gjuha dhe jeta", Albatros, Tiranë, 2006, f. 81.

rrafsh kuptimor i ri. Përvoja njerëzore ka thënë se poezia është një prirje mes të pashprehshmes dhe asaj që komunikohet. Poezia, por edhe çdo krijim tjetër artistik në analizë të fundit është një punë me gjuhën. Vlerësimi i mjeteve gjuhësore në një tekst letrar është thelbi i një analize stilistike. Në sajë të zhvillimit të stilistikës së re u bë e domosdoshme që studimi i llojeve letrare të bëhet paralel me gjuhën si mjet realizues i letërsisë. Tani është koha për të mos e konsideruar gjuhën letrare si diçka të krijuar *ex nihilo*; ajo është para së gjithash një zhvillim i mëtejshëm i gjuhës së të gjithëve; vetëm motivet biologjike e shoqërore të kësaj gjuhe bëhen motive estetike.

Kultura e të menduarit, pasqyrohet në atë të të shprehurit. Rrjedhimisht të kuptuarit e asaj që themi është po kaq e rëndësishme me të kuptuarit e asaj që lexojmë. Dhe këtë çelës e ka lënda e gjuhës e materializuar në trajtat artistike dhe joartistike. Sistemi i gjuhës është më i gjerë se mishërimi i tij konkret në një etapë të caktuar. Shprehësia del atje ku zgjedhja kërkon shtytje për të shquar diçka, për theksim, për vlerësim.

Në tekstet shkollore përgjithësisht nuk i kushtohet rëndësi stilistikës gjuhësore. Rubrikat për studim teksti konsistojnë në këto drejtime:

- Reflektoni për interpretimin, kuptimin, metrikën, gjuhën dhe stilin³. Vetëm me interpretimet e një mësuesi metodist këto rubrika marrin vlerën e një studimi stilistik gjuhësor të teksteve të ndryshme letrare ose joletrare që e përbëjnë atë.

Teksti letrar është strukturë relativisht e mbyllur, e ngritur mbi një strukturë tjetër të mbyllur, e cila i jep mundësinë të tejkalojë vetveten. Pra, për të njohur strukturën e tekstit letrar, e cila është edhe vetë kuptimi i tij, duhet para së gjithash ta njohim strukturën gjuhësore. Cilësia e informacionit nuk varet nga gjuha, por nga mënyra se si është shfrytëzuar ajo pra, kemi të bëjmë me zgjedhje, me mjeshtërinë gjuhësore të çdo poeti. Prandaj dhe një mësues i mirë duhet që të trajtojë brenda orës së mësimit dhe çështje të stilistikës gjuhësore. Rivlerësimi i një veprë letrare, interpretimi i saj sipas disa mjeteve specifike, që të sugjeron vetë vepra, në radhë të parë ndriçon anë të panjohura të saj, deshifron mesazhet që fshihen në tekstin poetik⁴.

Nga teksti “*Gjuha shqipe dhe letërsia 10-të*” botimet “Albas” kemi shkëputur poezinë “*Vdekja e Nositit*” e Lasgush Poradecit, poeti më i madh modern që u shfaq në vitet ’30 dhe një nga lirikët më të mëdhenj shqiptarë të shekullit të XX. Nevoja për vlerësime dhe rivlerësime të veprës së Lasgush Poradecit do të ndihet gjithmonë sepse është një vepër që implikon si lexuesin e thjeshtë ashtu dhe lëçitësin e specializuar.

³ R. Petro, L. Meniku, A. Marashi, *Gjuha Shqipe dhe Letërsia 10*, Albas, Tiranë, 2010.

⁴ Shih Xh. Lloshi, E. Muhametaj, *Figurshmëria e gjuhës në “Nga teoria e letërsisë dhe stilistika gjuhësore”*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1985, f. 91.

Në poezitë e Lasgushit është e dukshme vëmendja ndaj përzgjedhjes së leksikut. Nëpërmjet fjalorit, Lasgushi shquhet haptazi nga të gjithë poetët e tjerë të shqipes. Ai ka një fjalor të tijin, një fjalor të cilin dalëngadalë do të mësojmë t'i themi **lasgushian**. Puna nis me një vështrim të shpejtë leksikologjik të vargjeve të poezisë për të përcaktuar strofë pas strofe klasën leksikore të fjalëve, duke gjetur njëherazi edhe sasinë e emrave, mbiemrave, foljeve, ndajfoljeve, lidhëzave, parafjalëve, përemrave, pasthirmave dhe numërorëve, si dhe dendurinë e përdorimit të tyre. Kjo statistikë, krijon premisë për të kaluar nga sipërfaqja e tekstit në ndërtimin e brendshëm.

- Përsa i përket leksikut të përdorur nga autori themi që kemi një shpërndarje të njëtrajtshme dhe kjo shpjegon mënyrën mendimtare të rrëfimit ku, siç dihet, mbizotëron ndjeshmëria nga ana intelektuale.

Që në strofën e parë vihet re motivi i vetëfljimit. Këtë e vërteton më së miri emri **gjiri** si dhe dy emrat e tjerë antonime kontekstuale **shpresë** dhe **varr** me një semantikë të veçantë. Gjiri i tij shënon vdekjen e tij, është varri i tij. Në anën tjetër ka hapur gjirin që të ushqejë zogjtë dhe në këtë mënyrë i jep vetes shpresën që zogjtë nuk do të jenë më të uritur, pra trashëgimia do të vazhdojë.

Semantika e veçantë dallohet dhe në emra të tjerë të përdorur nga poeti herë-herë dhe duke e shpirtëzuar apo përkëdhelur fjalën si **liqerit zemërak**, **liqer-i shkret**, **shpirt i fellë** ku përveçse parapërgatitjes për më vonë (**liqerit zemërak**), kemi dhe një paralelizëm me gjendjen e dhimbjes shpirtërore të poetit e cila në këtë mënyrë merr më shumë hapësirë. Liqeni në fund të fundit ushqen jetën, e riciklon atë. Është i drejtpërdrejtë poeti dhe në vargun e pestë të strofës së pestë duke na dhënë thellësinë shpirtërore nëpërmjet fjalës **fund**, thellësinë e gjirit të hapur nga dhimbja thellësi që paraprihet nga foljet **tund**, **shkund**, **hap** të cilat janë shkalla e parë e ndjeshmërisë së kësaj dhimbjeje.

Në disa raste në këtë ligjërim poetik gjejmë të përdorura antonime si fjalë kundërshtuese dyshe të tilla si **dashuri-llaftari**, **tund-shkund**, **jap-marr**. Këto fjalë kundërshtuese jo vetëm që përcjellin dashurinë e poetit si një ndjenjë bipolare, por edhe japin qartë lidhjen dramatike të jetës dhe të vdekjes.

Autori i drejtohet lexuesit drejtpërdrejt, me folje në vetën e parë të tilla si **flas**, **kam hapur**, **t'i jap**, **ik**, **godas**, **vdes** etj., element që lidhet me natyrën sqaruese të ligjërimit poetik duke i dhënë më tepër patos, sepse përputhet me dhimbjen që do të shpaloset më tej në poezi, pra është një mënyrë ligjërimi sugjestionuese për lexuesin.

Në konceptin sosyrian gjuha konsiderohet kod, pra, një sistem shenjash ose më saktë një sistem lidhjesh të qëndrueshme në mes të shenjuesve dhe të të shënuarve. Shenja gjuhësore ka karakter të dyfishtë. Çdo unitet gjuhësor përbëhet nga dy anë, njëra është ndjesore (imazhi akustik) dhe tjetra është

racionale (koncepti që i vishet imazhit akustik). Filozofët e gjuhës kishin vënë re se shenjat janë mjeti për të transmetuar mesazhin.

I përmendëm të gjitha këto për arsye se në këtë poezi të bën përshtypje folja **vdes**. Në vetvete është e rëndë, e hidhur si fjalë, por në poezinë tonë vjen e ëmbël, vjen e pranueshme, vjen **vdekje me gaz** pa kurrfarë makabriteti, dhembje ekzistenciale, pa kurrfarë tmerri që të sugjeron akti i vdekjes, vjen si shërim, si shpërblim i asaj që ka jetuar, si meritim. Është pikërisht fjala shenjë **gaz** që mposht tonin makabër të vdekjes.

Nuk mungojnë gjithashtu fjalët e rralla si dhe përdorimi i trajtave dialektore. **Liqerit, llaftari, mun, gjit, fellë, pjellë, gjir'i em, dyke, tallazin** janë disa prej këtyre fjalëve apo trajtave të cilat edhe njëherë tregojnë për një përdorim gjuhësor të palëvruar nga poetët e mëparshëm pra, kuptojmë sesa shumë Lasgush Poradeci e ka gjallëruar leksikun e gjuhës shqipe. Me një kuptim konotativ del dhe fjala **mall**, këtu si faktor shpirtëror si dashuri, si energji, si forcë kozmike. Fenomenet lidhen me njëra-tjetrën, lidhja është organike, ajo nis prej një shtyse madhore, prej frymës që i jep qëllim.

- Në rrafshin fonetik të bie në sy ritmi i shpejtë në përputhje të plotë me rrjedhën e mendimeve dhe të ndjenjave që shpreh poezia duke përçuar tek lexuesi ndjenja të vrullshme e veprime të gjalla duke ndikuar në mënyrë sugjestionuese tek ai. Përbërësit tingullorë, anët e sistemit tingullor dalin në dukje, duke ndërthurur fjalët e vargjet që të bëhen të perceptueshme këto anë për efekt shprehës dhe sidomos për bukurtingëllim e muzikalitet.

Vihet re një ndërrim i rregullt dhe në largësi të njëjtë i theksave dhe togjeve fonetike, por dhe i leksemave dhe i njësive sintaksore. Të bie në sy fakti që për secilën strofë të poezisë vargjet mbarojnë me të njëjtën zanore apo bashkëtingëllore. Kështu, në strofën e parë vihet re mbarimi i vargjeve me tingullin **-rr** që është konsideruar si tingull revolucionar, pëlcitës, dridhës dhe i zëshëm duke marrë trajtën e rrëkesë së rreptë që në fillim, e cila duket se e tillë mbetet dhe në fund. Më pas në strofën e dytë vihet re mbarimi i vargjeve me tingullin **-k** si një orkestrim tingullor i përpunuar dhe i thellë, parapërgatitje për një dhimbje shpirtërore. Vazhdon poezia në strofën e tretë me një zanore në fund të vargut dhe pikërisht me zanoren **-i** e cila ka për bashkëshoqëruese të saj zanoren tjetër **-ë** në strofën e fundit. Të dyja këto zanore japin përshtypjen e lehtësisë, haresë, qartësisë dhe të lirizmit që përshkon poezinë, janë zanore që shprehin ndjesinë e vuajtjes dhe të dhembshurisë.

Vargjet e dy strofave që pasojnë rimojnë përkatësisht me tingujt **-s**, **-t**, dhe **-d**. Rima e mbaruar me tingullin **-s** është e hapur, ajo shoqërohet në trajtën e një fëshfërimie vazhdimësie që në fund sjell paqen e dëshiruar për poetin. Ndërsa tingujt **-t** dhe **-d** sjellin drithërimën e cila ka bërë vend në fjalët *buçet, shkret, shkund, mund, fund*. Në strofën e parë, të dytë dhe të tretë gjendet zanorja **-a** para tingujve fundorë përkatës të tyre e cila të ngjall përshtypjen e një peshe të rëndë apo të një diçkaje shumë të rëndësishme. Ritmi fundor i

vargjeve e bën ligjërimin të prerë i cili gjen mbështetje dhe në anën akustike me përdorimin e pasthirmave **ah!** të përsëritura në të treja vargjet e strofës së katërt duke na dhënë kështu ritmin e prerë të goditjes së sqepit në gjoks me një ndarje të vargut në mes si shenjë shkëputjeje, shkuljeje shenja të dhimbjes së madhe. Mbas përsëritjes së tretë të klithmës **ah!** poeti përdor emrin fatsjellës **gas** duke e shpirtëzuar përsëri atë si për të na treguar shpirtin që qëndron mbi dhimbjen dhe mbi vdekjen, atë shpirt poetik që shfaqet në formën e mallit për një përjetim të madh ndjenjash dhe emocionesh që në mënyrë metaforike nëpërmjet vargut **“Ky gjir”i em që të pat pjellë**” venë në lëvizje liqenin, pra jetën drama e së cilës shkon në një lëvizje sa lart- poshtë e përsëri nga poshtë –lart, riciklim sipas ligjeve natyrore dhe të atyre njerëzore, rikthimi i Nositit aty ku ka filluar gjithçka, duke lënë pas trashëgiminë. Gjithashtu, përforcon lidhjen e ngushtë të poetit/ Nosit me liqenin/vendlindjen, pra lidhjen arkaike nënë- bir.

Mbyllja me të njëjtin varg është kornizë estetike e poezisë, por dhe kuptimore, ligjërimi nuk ndërpritet, por rifillon që përforcon idenë se flijimi nuk ka shkuar kot është lajtmotiv i kësaj poezie duke përcjellë tek lexuesi optimizmin dhe triumfin e përjetshëm të artit⁵.

Një magji e pastër e gjuhës shqipe përcillet në këtë poezi, forcë magjike e tingujve, në radhitjen objektive, në radhitjen logjike, afektive dhe madje gramatikore. Poeti mbështetet në mënyrë konsekuente në këtë magji të gjuhës, një tipar konstant i lirikës moderne, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë tingullore dhe asociative të fjalës, duke lidhur përmbajtje të errëta pa kuptim, por dhe fuqi misterioze, magjike, të tingëllueshmërisë së pastër. Rrjeti i tensionit të poemave lasgushiane përbëhet nga energji analoge që njeh vetëm muzika. Kjo poezi do të dallohet për vijimin e gradëve të intensitetit, për lëvizjet absolute, ngjitëse dhe zbritëse, në alternancë midis akumulimit dhe shkarkimit. Poeti e refuzon gjuhësisht vendngjarjen dhe kohën e ndodhjes, duke krijuar hapësira dhe shtrirje universale.

Në përfundim mund të themi se i përmbahemi mendimit për një analizë stilistike gjuhësore, e cila kërkon t’i qëndrosh sa më afër tekstit, të shqyrtosh elementet gjuhësorë të tij (pa rënë natyrisht në një analizë thjesht artistike apo thjesht linguistike)⁶. Mësuesi merr shkas nga ato që di ai vetë për një shkrimtar dhe përpiket t’i gjejë në tekstin për studim. Analiza e vërtetë stilistike nis nga vetë teksti për të shkuar tek autori. Kjo mënyrë i krijon mundësinë nxënësit të gjykojë e të mendojë në mënyrë të pavarur. Në sajë të zhvillimit të stilistikës së re u bë e domosdoshme që teoricieni i letërsisë të

⁵ Shih Xh. Lloshi, E. Muhametaj, *Vjershërimi* në “Nga teoria e letërsisë dhe stilistika gjuhësore”, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1985, f. 111.

⁶ Shih Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 6.

mos e nisë analizën e veprës letrare apo studimin e llojeve letrare pa e njohur gjuhën si mjet realizues i letërsisë.

BIBLIOGRAFIA

- Gjuha shqipe dhe leximi letrar*, në “Kurrikula dhe shkolla”, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2001/1, f. 89.
- R. Petro, L. Meniku, A. Marashi, *Gjuha Shqipe dhe Letërsia 10*, Albas, Tiranë, 2010.
- R. Petro, L. Mëniku, *Për gjuhën e letërsisë* në “Çelësi i letërsisë dhe gjuhës shqipe”, Albas, Tiranë, 2012, f. 27.
- Sh. Bali, përkthyer nga M. Samara, *Dy konceptime për stilistikën* në “Gjuha dhe jeta”, Albatros, Tiranë, 2006, f. 81.
- Xh. Lloshi, E. Muhametaj, *Figurshmëria e gjuhës* në “Nga teoria e letërsisë dhe stilistika gjuhësore”, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1985, f. 91.
- Xh. Lloshi, E. Muhametaj, *Vjershërimi* në “Nga teoria e letërsisë dhe stilistika gjuhësore”, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1985, f. 111.
- Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 6.